



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

A PO SHKON KOSOVA DREJT ZGJEDHJEVE TË JASHTËZAKONSHME PARLAMENTARE?

FAQE 4-5



Kuvendi i Kosovës ka mbetur ende i pakonstituuar, pasi ende nuk është zgjedhur nënkryetari nga komuniteti serb. Procesi i formimit të institucioneve të dala nga

zgjedhjet e 9 shkurtit ka mbetur në bllokadë. Rreth kësaj situatë të krijuar në vend, analistët politikë si opsion po i shohin zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare. Ata

kanë theksuar se kjo situatë bllokuese po krijon tensione të reja dhe pasiguri në skenën politike, që edhe në të ardhmen rrezikon të sjellë më shumë kontradikta

EURODEPUTETI
MANDL
DËGJON
SHQETËSIMET
E OVLUÇK-së
PËR ZHVILLIMET
NË HAGË

F. 3



IKD-ja THOTË
SE MINISTRAT
E QEVERISË
KURTI II
USHTRUAN POZITA
NË MËNYRË TË
KUNDËRLIGJSHME

F. 4



RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

AKTUALE



POLONIA THOTË SE RRËZOI DRONË
RUSË QË U FUTËN NË HAPËSIRËN
E SAJ AJRORE

F. 2

AKTAKUZË NDAJ FARUK
MUJKËS PËR KEQPËRDORIM
TË DETYRËS

F. 7

22 SHËRBIME TË REJA PËR
AUTOSHKOLLË LANSOHEN NË
PLATFORMËN E-KOSOVA

F. 6

EKONOMI



MILIONAT MBETEN PA
U SHFRYTËZUAR, POR BUXHETET
KOMUNALE RRITEN

F. 8

HYSANI: SYNIMI YNË ËSHTË
NDËRTIMI I NJË DIALOGU TË
HAPUR DHE TË VAZHDUESHËM
ME KOMUNITETIN E BIZNESEVE

F. 8

SPORT



SHAQIRI RRËFEN PËR PËRVOJAT NË
INTER, BAYERN, LIVERPOOL DHE
KTHIMIN NË BASEL

F. 10

Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

SHEFJA E KOMISIONIT EVROPIAN KËRKON SANKSIONE DHE PEZULLIM TË PJESSHËM TË TREGTISË ME IZRAELIN

BRUKSEL, 10 SHTATOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, njoftoi të mërkurën se do të kërkojë sanksione dhe pezullim të pjesshëm të tregtisë me Izraelin për shkak të luftës në Rripin e Gazës. Bashkimi Evropian, i cila ka 27 vende anëtare, është thellësisht i ndarë mbi qasjen ndaj Izraelit dhe palestinezëve, dhe nuk është e qartë nëse do të gjendet një shumicë e nevojshme për t'i mbështetur sanksionet dhe masat tregtare kundër Izraelit. "Ajo që po ndodh në Gazë ka tronditur ndërgjegjen e botës", tha von der Leyen në një fjalim para Parlamentit Evropian në Strasburg. Von der Leyen shtoi se komisioni "në muajin e ardhshëm do të

krijojë një grup donatorësh për palestinezët" një pjesë e të cilit do të përqendrohet në rindërtimin e ardhshëm të Gazës. "Uria e shkaktuar nga dora e njeriut nuk mund të jetë kurrë armë lufte. Për hir të fëmijëve, për hir të njerëzimit. Kjo duhet të ndalet", shtoi ajo, duke marrë duartrokitje në Parlament. Fjalimi i saj erdhi një ditë pasi ushtria izraelite i paralajmëroi banorët e qytetit të Gazës të evakuhohen para se ta nisë ofensivën e gjerë për ta marrë nën kontroll qytetin, i cili thuhet të jetë bastioni i fundit i Hamasit - grupit të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Izraeli i bëri këtë paralajmërim të martën para një sulmi ndaj

liderëve të Hamasit në Katar, ku negociatat për përfundimin e luftës në Gazë dukej se kishin ngecur. Lufta në Gazë filloi kur militantët e udhëhequr nga Hamasi rrëmbyen 251 njerëz më 7 tetor të vitit 2023 dhe i vranë rreth 1 200 të tjerë, kryesisht civilë izraelitë. Në Gazë po mbahen edhe 48 pengje, rreth 20 prej të cilëve besohet se janë gjallë. Në luftën hakmarrëse Izraeli ka vrarë mbi 64 000 palestinezë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës, ka zhvendosur pothuajse të gjithë popullsinë dhe rrënuar pjesën më të madhe të territorit. Shumë pjesë të qyteteve kryesore janë shkatërruar plotësisht dhe rreth 90 % e rreth dy milionë palestinezëve janë zhvendosur brenda vendit.



POLONIA THOTË SE RRËZOI DRONË RUSË QË U FUTËN NË HAPËSIRËN E SAJ AJRORE



VARSHAVË, 10 SHTATOR - Polonia njoftoi mëngjesin e së mërkurës se ka rrëzuar një numër të papërcaktuar dronësh rusë që kishin hyrë në hapësirën e saj ajrore, duke e quajtur këtë "akt agresioni". Ushtria e Polonisë tha se dronët shkelën në mënyrë të përsëritur hapësirën ajrore polake mëngjesin e së mërkurës, pasi Rusia e kishte nisur një valë sulmesh ajrore në Ukrainë, përfshirë edhe afër kufirit me Poloninë.

Kryeministri i Polonisë, Donald Tusk, shkroi në X se ishte njoftuar nga Komanda Operacionale e Ushtrisë lidhur me "rrëzimin e dronëve që u futën në hapësirën tonë ajrore dhe që mund të përbënin kërcënim". Ai tha se e ka njoftuar edhe sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, për veprimet e ndërmarra nga pala polake. Nuk raportohet për viktima në Poloni dhe mbetet e paqartë sa dronë kishin hyrë në

hapësirën ajrore të Polonisë. Ushtria tha se është duke kërkuar për mbetjet e dronëve të rrëzuar. "Ky është akt agresioni që paraqiti kërcënim real për sigurinë e qytetarëve tanë", shkroi Komanda Operacionale e Ushtrisë në një postim në X. Ndërkohë, deri tani nuk ka ndonjë reagim nga Ministria e Mbrojtjes e Rusisë. Polonia tha, gjithashtu, se i ka mbyllur katër aeroporte, përfshirë aeroportin kryesor të vendit në Varshavë.

MACRONI EMËRON LECORNUN KRYEMINISTËR TË FRANCËS

PARIS, 10 SHTATOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, e ka emëruar besnikun e tij, Sebastien Lecornu, kryeministër të ri të vendit, pavarësisht prej pritshmërisë se mund ta zgjidhte dikë nga e majta. Zgjedhja e 39-vjeçarit Lecornu lë të kuptohet se Macroni është i vendosur për të vazhduar me një qeveri pakicë, e cila nuk do të heqë dorë nga agjenda e tij probiznesit, në kuadër të së cilës taksat për biznesin dhe të pasurit janë ulur dhe mosha e pensionit është rritur. Megjithatë, në një lëvizje të pazakontë në politikën franceze, zyra e Macronit tha se presidenti i ka kërkuar Lecornut të mbajë bisedime me të gjitha forcat politike në Parlament për të gjetur kompromise mbi buxhetin dhe politikën e tjera para se ta emërojë kabinetin e tij. "Presidenti i Republikës më ka ngarkuar me detyrën për të ndërtuar një qeveri me një

drejtim të qartë: mbrojtjen e pavarësisë dhe fuqisë sonë, shërbimin ndaj popullit francez dhe stabilitetin politik e institucional", shkroi Lecornu në X. "Dua ta falënderoj për besimin që tregoi ndaj meje duke më emëruar kryeministër", shtoi ai. Lecornu do të bëhet kryeministri i pestë i emëruar nga Macroni në më pak se dy vjet, pasi Parlamenti, i ndarë thellësisht mes tri kampeve ideologjike kundërshtare, e rrëzoi të hënën François Bayroun për shkak të planeve të tij për ta frenuar borxhin e shtetit që po rritet me shpejtësi. Lajmi për emërimin e tij u prit me përqeshje nga partitë e majta, të cilat bënë thirrje që votuesit ta shprehnin kundërshtimin e tyre në protesta mbarëkombëtare "Blloko Gjithçka" të mërkurën. Partia e majtë ekstreme Franca e Papërkulur tha se do ta paraqesë



një votëbesim për Lecornun, megjithëse duket se nuk do të mund ta bëjë këtë, sepse presidenti i partisë së ekstremit të djathtë Tubimi Kombëtar (RN), Jordan Bardella, shfaqti gatishmëri për të bashkëpunuar me Lecornun për buxhetin - tani për tani. Kjo do ta bënte Lecornun dhe qeverinë t'i varë shpresat në tekat e RN-së, e cila ka qenë

vendimtare në rrëzimin e Bayrou dhe paraardhësit të tij Michel Barnier. "Ne do ta gjykojmë - pa iluzione - kryeministrin e ri mbi meritat e tij, mbi veprimet e tij, mbi politikën e tij për sigurimin e një buxheti për Francën, dhe këtë në dritën e vijave tona të kuqe", shkroi Bardella në X. RN-ja ka thënë se nuk do të pranojë rritje taksash për

punëtorët. Kjo parti, gjithashtu, kërkon shkurtim të pagesave për emigrantët, shpenzimet e larta të nëpunësve civilë dhe kontributin e Francës në Bashkimin Evropian. Lecornu e ka pasur herë pas here vëmendjen e lideres së RN-së, Marine Le Pen, dhe të Bardellas, me të cilët pati darkë të fshehtë vitin e kaluar. Lecornu hyri në politikë duke bërë fushatë për ish-presidentin Nicolas Sarkozy kur ishte 16 vjeç. Ai u bë kryetar bashkie i një qyteti të vogël në Normandi kur i mbushi 18 vjet dhe më pas këshilltari më i ri i qeverisë i Sarkozyt në moshën 22-vjeçare. Ai la partinë konservatore Les Republicains për t'iu bashkuar lëvizjes politike qendrore të Macronit kur ky i fundit u zgjodh president më 2017. Pesë vjet më vonë ai drejtoi fushatën e rizgjedhjes së Macronit.

Haradinaj përkrah protestën në Hagë

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Ish-kryeministri dhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka përkrahur fuqishëm protestën që do të

mbahet afër Gjykatës Speciale në Hagë, në të cilën do të kërkohet drejtësi për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Këtë të diel, më 14 shtator,

bashkatdhetarët tanë në mërgatë dhe organizatat e dala nga lufta, protestojnë në Hagë për drejtësi. Qëndroj fuqishëm krah kësaj proteste dhe

përpjekjes së drejtë për t'i thënë botës se lufta jonë ka qenë çlirimtare dhe e drejtë”, ka shkruar Haradinaj në rrjetin social “Facebook”.



EURODEPUTETI MANDL DËGJON SHQETËSIMET E OVLUÇK-së PËR ZHVILLIMET NË HAGË



PRISHTINË, 10 SHTATOR - Përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe Gazmend Sylja, janë takuar në ambientet e Parlamentit Evropian në Strasburg me eurodeputetin Lukas Mandl. Përfaqësuesit e kësaj organizate ia kanë paraqitur eurodeputetit austriak shqetësimet lidhur me zhvillimet në Gjykatën Speciale. “Përfaqësuesit e OVL UÇK-së, kryetari Hysni Gucati dhe nënkryetari Gazmend Sylja, paraqitën me seriozitet shqetësimet tona lidhur me zhvillimet në Gjykatën Speciale, duke theksuar domosdoshmërinë e mbrojtjes së dinjitetit të luftës sonë çlirimtare dhe të vlerave mbi të

cilat është ngritur liria e Kosovës. Z. Mandl i dëgjoi me vëmendje dhe mirëkuptim qëndrimet tona, për çka e falënderojmë sinqerisht. E lutem që ta përcjellë këtë mesazh tek kolegët e tij në Parlamentin Evropian dhe në institucionet përkatëse të shtetit të tij, duke i dhënë kështu zë dhe mbështetje kauzës sonë të drejtë”, ka njoftuar OVLUÇK-ja. Po në njoftim është thënë se takimi përbën një hap domethënës në kuadër të përpjekjeve tona për ta sensibilizuar opinionin ndërkombëtar dhe për të ndërtuar partneritete të qëndrueshme në mbrojtje të së vërtetës dhe drejtësisë.

BDI: A PO BËHET MAQEDONIA ‘REPUBLIKA E TRETË SERBE’?

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) shpreh shqetësim të thellë dhe alarmon opinionin publik, se Maqedonia e Veriut po përballet me një ofensivë të hapur të projektit famëkeq të “Botës Serbe”. “Ky projekt po manifestohet gjithnjë e më shpesh në mënyrë zyrtare, me praninë dhe, fatkeqësisht, me bekimin e përfaqësuesve shtetërorë të vendit tonë. Pas festimeve në Manastir, ku delegacioni i lartë i Serbisë, bashkë me ministra dhe zyrtarë të Qeverisë sonë, nën petkun e ‘Frontit të Selanikut’ kremtuan pushtimin serb të territoreve

tona, më 7 shtator 2025 në Kajmakçalan dëgjuam edhe një deklaratë skandaloze të ministrit serb të Mbrojtjes, Bratislav Gashiç, i cili foli për ‘rrugën e lirisë’ dhe ‘kthimin në atdhe’ të ushtrisë serbe në tokën e Maqedonisë”, thuhet në reagimin e BDI-së. Sipas BDI-së, pjesëmarrja e institucioneve tona në këta skenarë është jo vetëm provokim i rëndë historik dhe politik, por edhe përpjekje për ta relativizuar sovranitetin e shtetit tonë, duke e paraqitur Maqedoninë e Veriut si “Republika e tretë serbe”. “Kjo është e papranueshme. Është



kërcënim direkt ndaj identitetit, stabilitetit shtetëror dhe orientimit euroatlantik të vendit. BDI thekson qartë: projekti i ‘Botës Serbe’ është armiqësor për Maqedoninë e Veriut. Marrëveshja e Ohrit, kohezioni multietnik dhe rruga jonë e pakthyeshme drejt Bashkimit Evropian janë garancia jonë e vetme për një të ardhme të sigurt. Çdo tentativë për t'i minuar këto vlera do të hasë në kundërshtimin tonë të vendosur, pa kompromis. Maqedonia e Veriut nuk është, dhe kurrë nuk do të bëhet ‘Republika e tretë serbe!’, është thënë në reagimin e BDI-së.

ÇDO VIT NË GJITHË BOTËN REGJISTROHEN MBI 700 000 VETËVRASJE

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**
PRISHTINË, 10 SHTATOR - Me moton “Ndryshimi i perceptimit mbi vetëvrasjen”, të mërkurën në mbarë botën është shënuar Dita Botërore e Parandalimit të Vetëvrasjes, e cila ka për qëllim përfshirjen e individëve, komunitetit, organizatave dhe qeverive në biseda të hapura dhe të sinqerta rreth vetëvrasjes dhe sjelljes

vetëvrasëse. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se vetëvrasja është një problem serioz i shëndetit publik, që ka pasoja të thella sociale, emocionale dhe ekonomike. Aktualisht në mbarë botën regjistrohen mbi 700 000 vetëvrasje çdo vit, ku çdo vetëvrasje prek thellësisht shumë njerëz në mënyra të ndryshme. “Ndryshimi i perceptimit mbi vetëvrasjen është i domosdoshëm për të tejkaluar

barrierat e heshtjes dhe mungesës së mirëkuptimit. Kjo kërkon kalimin drejt një kulture hapjeje, empatie dhe mbështetjeje të ndërsjellë. Përmes ndërgjegjësimit dhe krijimit të kulturave më të forta mbështetëse, mund të parandalohen shumë tragjedi”, ka njoftuar ky institut. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2021, në Kosovë janë regjistruar 19 vdekje nga vetëlëndimi i




qëllimshëm, prej të cilave 16 janë meshkuj dhe 3 femra.

Vetëvrasja është një sfidë globale që kërkon reagim të shpejtë dhe të koordinuar. Me ndërhyrje të bazuara në dëshmi, shpesh me kosto të ulët, vetëvrasjet mund të parandalohen. Ministria e Shëndetësisë u bënë thirrje të gjithë qytetarëve, institucioneve dhe organizatave që të jenë pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për parandalimin e vetëvrasjes. Ndihamë është gjithmonë e mundshme, askush nuk duhet të përballet vetëm.

A PO SHKON KOSOVA DREJT ZGJEDHJEVE TË JASHTËZAKONSHME PARLAMENTARE?

Kuvendi i Kosovës ka mbetur ende i pakonstituuar, pasi ende nuk është zgjedhur nënkryetari nga komuniteti serb. Procesi i formimit të institucioneve të dala nga zgjedhjet e 9 shkurtit ka mbetur në bllokadë. Rreth kësaj situatë të krijuar në vend, analistët politikë si opsion po i shohin zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare. Ata kanë theksuar se kjo situatë bllokuese po krijon tensione të reja dhe pasiguri në skenën politike, që edhe në të ardhmen rrezikon të sjellë më shumë kontradikta

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar një ditë më parë se i ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese komentet lidhur me rastin e nënkryetarit serb të Kuvendit. Osmani në një konferencë për medie ka thënë se nuk mund të bllokohet shteti për një nënkryetar të Listës Serbe, e cila është duke insistuar se kjo pozitë i takon vetëm asaj. “Po synohet që për një nënkryetar të bllokohet shteti në tërësi. Një shtet pa institucione është shtet i dështuar. Është detyrë të bllokojmë çdo synim për ta arritur synimin e dështimit të Kosovës”, ka deklaruar Osmani. Presidentja tha se shpreson se Gjykata Kushtetuese do të marrë vendim për ta shpallur të konstituuar Kuvendin e Kosovës dhe që vendi t’i themelojë shpejt institucionet e reja, pothuajse shtatë muaj pas zgjedhjeve të shkurtit. “Menjëherë pas 30 shtatorit... me shpresën që do të ketë vendim në frymën pozitive të konstituimit, po atë ditë do ta thërras partinë e parë dhe menjëherë do të procedojë edhe me caktimin e mandatarit. E pastaj punët e tjera janë në duar të partive, kush e krijon shumicën, si e krijojnë shumicën, si votohet qeveria,

ato pastaj janë jashtë këtij institucioni”, tha Osmani. Rreth kësaj situatë të krijuar në vend analistët politikë si opsion po i shohin zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare. Analisti Shenoll Muharremi ka thënë se ka filluar të krijohet njëfarë urgjence për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare. “Koha po ecën shpejt, e sidomos duket që urgjenca po vjen prej partisë më të madhe të vendit. Kohët e fundit kemi parë edhe disa qëndrime të presidentes që, ndoshta, kanë sjellë konfuzion e frikë në publik. Nevojitet që mesazhet dhe qëndrimet të sjellin stabilitet, qartësi dhe qetësi. Sfidat aktuale politike nuk janë krijuar as prej gjykatave e as prej pakicave, por janë probleme politike. Thelbi i problemit është që shumica politike demokratike (50 %+) ende nuk ekziston”, ka thënë Muharremi. Ai ka theksuar se Kosova aktualisht, pas 4-5 viteve të qeverisjes “socialiste”, është në një tranzicion politik prej së majtës kah e djathta. “Por procesi nuk është kompletuar, e kjo po krijon tensione të reja dhe pasiguri në skenën politike dhe rrezikon të sjellë edhe më shumë kontradikta dhe mosdurim. Ndoshta po tentohet që përmes instrumentalizimit dhe presionit ndaj Gjykatës

Kushtetuese me i ‘detyru’ zgjedhjet sa më shpejt. Por puna është që edhe zgjedhjet duhet me u dakordu me bashkëpunim politik dhe marrëveshje. Qasja e ‘detyrës’ mund të sjellë efekte negative dhe nuk është e dobishme aspak. Edhe presidentja, në vend se të bëhet pjesë aktive e lojës, duhet shumë më tepër ta luajë rolin e saj kushtetues dhe të sigurojë dialog politik intensiv dhe t’i pajtojë partitë për afatin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme nacionale”, është shprehur ai, duke shtuar se partitë politike, liderët, duhet të takohet dhe përmes një marrëveshje të pajtohen për afatet e zgjedhjeve të reja të jashtëzakonshme. “Tashmë janë pjekur shumica e kushteve dhe mund të caktohet një afat i përbashkët”, ka deklaruar Muharremi. Por, ai ka thënë se zgjedhjet nuk do të thotë se japin zgjidhje automatikisht. “Shumica ende nuk ekziston dhe Kosova është në tranzicion. Nevojitet leadership politik me vizion dhe ndryshime dhe adaptime të qëndrimeve, sidomos te blloku i djathtë, që Kosova të arrijë ta formojë shumicën e re. Nëse kjo nuk ndodh, kriza mund të vazhdojë edhe pas zgjedhjeve të reja”, ka thënë Muharremi. Ndërkaq drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se

ka kaluar tashmë një vit nga gushti i vitit 2024, kur presidentja e Kosovës i pat shpallur zgjedhjet parlamentare. Sipas tij, që nga ajo kohë parti të politike janë përfshirë në aktivitete dhe fushatë zgjedhore të pandërprerë, pa arritur t’i krijojnë institucionet dhe t’i përmbushin obligimet që burojnë nga zgjedhjet. “Prej vitesh opozita rrallëherë ose pothuajse asnjëherë nuk është mobilizuar për të ushtruar presion real ndaj LV-së si parti në pushtet në mënyrë që të kërkojë llogaridhënie. Në praktikë, pothuajse i gjithë aktiviteti opozitar është reduktuar në ankesa dhe në raste të dërguara në Gjykatën Kushtetuese. Kjo tkurje e rolit opozitar në një betejë kryesisht juridike e ka zhveshur atë nga dimensionin politik dhe mobilizues që pritet nga një opozitë funksionale. Për më tepër, gjatë vitit të fundit partitë opozitare janë përfshirë dhe janë bërë pjesë e gjenerimit të krizave politike dhe institucionale, duke u bërë kështu bashkëpërgjegjëse me LV-në për bllokimin e funksionimit të institucioneve”, ka thënë Kryeziu. Ai ka shtuar se ngërçi aktual politik dhe institucional nuk është vetëm përgjegjësi e një subjekti politik, por e të gjitha subjekteve parlamentare, të cilat, me votimet, mosvotimet

apo barrikadimet e tyre, e kanë ndihmuar partinë më të madhe të zbatojë politika bllokuese që kanë penguar formimin e Kuvendit dhe të qeverisë. “Edhe sot partitë opozitare ende nuk janë duke e zhvilluar një betejë politike me partinë më të madhe”, ka thënë Kryeziu. Javën e kaluar Gjykata Kushtetuese vendosi njëzëri masë të përkohshme përmes së cilës ua ndaloi deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të ndërmarrin veprime si dhe ua ndaloi zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e qeverisë së re. Gjykata e vendosi këtë masë - që do të jetë në fuqi deri më 30 shtator - në mënyrë ex officio dhe në bazë të kërkesës së deputetëve të Listës Serbe. Nëntë deputetë të Listës Serbe dhe deputeti goran Adem Hoxha iu drejtuan Kushtetueses me kërkesë më 30 gusht, lidhur me votimin për nënkryetarin serb në Kuvendin e Kosovës. Vetëvendosja, e cila e ka të drejtën e mandatarit e para, e propozoi sërish Albin Kurtin për kryeministër në një takim të partisë në fundjavë. Megjithatë, Vetëvendosja me 48 ulëse në Kuvend nuk e ka shumicën dhe i duhet të arrijë marrëveshje për koalicion qeverisës për ta formuar qeverinë në rast se gjykata e jep dritën jeshile pas 30 shtatorit.

KOSOVA NË VDEKJE KLINIKE



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kur marshojnë antikombëtarët: Mendermethënë kryetar i Kuvendit u zgjodh Dimal Basha, një anti-UÇK i thekur nga sera e LV-së ku kultivohen, rriten dhe shumohen antikombëtarët dhe kundërshtarët e luftës çlirimtare. Që ujiten me helmin e nepërkës Mihali dhe plehërohet nga “plehrat” si Hekurani, Hajnrullahu, Sipeci, Limoza Kulari, Katrane Zeza dhe shumë të tjerë. Askush deri sot nuk e ka sulmuar UÇK-në dhe luftën çlirimtare se sa ky bari i keq që po përhapet në Kosovë. Askush nuk i ka sulmuar çlirimtarët më shumë se partia antikombëtare që alfa dhe omega e angazhimit të tyre e kanë pasur bashkimin kombëtar. Tash, ka pendesa dhe kërkimfalje publike pse qenka votuar Dimal Basha ky injorant dhe palaço nga sera e LV-së. Thonë se nuk e kanë ditur se paska shkruar kundër UÇK-së. Asgjë e re dhe e papritur. Pse e votuan mirë bënë sepse e nxorën në livadh LV-në. LV-ja sigurisht e ka ditur të kaluarën e Dimalit e që ka qenë faturë për të përparuar në karrierë. Në fund të fundit ma gjeni vetëm një në LV që mbanë ndonjë post e që ka qëndrim më të mirë se Dimali?! Nuk e gjeni, as për ilaç. E patë se sa e paskrupullt u tregua Vojsa Osmani duke mbrojtur Dimalin me gënjeshtre se: “gjatë bisedave me te (Dimalin) ishte bindur se ai paska qëndrim afirmativ për luftën çlirimtare. Rrenë qoftë dhe rrenë është! Po edhe presidentja e Kurthit është patriotë për aq sa është Dimali,

janë të një brumi, asgjë kombëtare nuk kanë në trupin apo mendjen e tyre. Së shpejti për Vojsën do ta këndojmë këngën se: “ra Vojsa prej fiku ..” kurse Dimali do të bëhet pjesë e kanalizimit historik dhe kombëtar. Do të përfundojë si ligjërues në fakultetin juridik në Nish - Serbi apo si bisht politik i Arsovshtës. Po të ishte në Kroaci, moti do të mbetej pa pupla. Veteranët tanë po merren me “aktivitete diplomatike..”! Të burgosurit politikë po e përcjellin njëri - tjetrin në varreza! Disa po ia mbajnë zhagun Kurthit. Poshtë kemi ra, pabesueshëm poshtë. Krejt shpresat i kam varur te Kadri Kryeziu që, si Dedë Gjo Luli lëshoi kushtimin me zotim publik se është i këtynehershit, nuk dorëzohet bashkë me 3950 të burgosur politikë dhe se do të harrohet Oso Kukanëse nuk votohet Rashiqi i Livaxhesë ose nëse votohet Sllavko Simiqi që bisedonte, në emër të Radoiçiqit me sekseren e Kurthit, Limoza Kularin, zemlaken e Millanit. Kadri, mos llogarit se unë do të sakrifikohem për këtë xhihad që e ke shpallur, jo për ta mbrojtur Kosovën por për ta luftuar Enverin, në emër të Kurthit e mbiemër të Mihalit. Ke një të kaluar kombëtare dhe të lavdishme, ruaje këtë kapital të çmuar. Historia sot është mohim i të kaluarës sonë të përbashkët me plotë vuajtje, dhimbje dhe krenari. Këta Kadri në vend të shurrës kanë përshurrë Cocacola kurse ne, ish të burgosurit politikë rrallë kemi përshurrë por kryesisht gjak! Mos e harro këtë asnjëherë. Këta kanë sharë Bacën Adem Demaçi dhe Adem Jasharin e lëre më neve, vdekatarëve të thjeshtë. Kuptoje se nuk është problemi te Sllavko Simiqi e as te Nenad Rashiqi, këta maksimalisht i kanë 10 vota përballë 110 votave prandaj nuk mund të bllokojnë asgjë dhe asnjëherë. Bllokimin e bëjnë shumica duke manipuluar

me patriotizëm, jo shqiptar sepse nuk e kanë atë brumë, janë gatim nga brumi jugosllav dhe serb. Më gjej sot patriotë në LV, bëre një listë prej 10 vetëve nga një lukuni harbutësh që kanë poste që as në ëndërr nuk i kanë parë. Kosova sot është e paralizuar nga një pozitë antikombëtare dhe antishtetërore dhe një pozitë që ka qenë kombëtare dhe shtetformuese por që sot ka mungesë guximi për ta mbrojtur shtetin që vet e ka krijuar, me shumë sakrifica. Pse Simiqi ishte i mirë për nënkryetar Kuvendi në vitin 2021 kur u votua edhe nga LV me 91 vota e sot nuk po bëjka! Rregullorja e vitit 2022 e bërë nga LV e ka pajisur LS-në me ekskluzivitete për postin e nënkryetarit të Kuvendit e jo Rregullorja e vitit 2012 e bërë nga opozita aktuale. Kosovën nuk e rrezikon zbatimi i Kushtetutës aktuale por mosbatimi i saj. Gjyqtarët e GJK-së shkojnë e vijnë, Kushtetuta mbetet. LV-ja Gjykatën Kushtetuese përpiqet ta bëjë si Vojsa Osmanin, një kukull personale e Kurthit, pa të kaluar kombëtare dhe politike, pa dinjitet fare dhe një karrieriste e paskrupullt . Si mund të ketë të ardhme me një të tashme të tillë?!

Një propagandë e ndyrë e mendësisë jugosllave: Krahu i luftës dhe krahu i paqes janë në defansivë të plotë ndaj një mekanizmi antikombëtar dhe keqbërës që është sot në pushtet dhe nuk zgjedhë mjete të mbajë pushtetin. Në vend se të kundërshtojnë me të gjitha mjetet e mundshme dhunimin e fryteve të sakrificës së tyre, ata janë shndërruar në vrojtues indiferentë që nënkupton se me mosveprim e marrin një pjesë të përgjegjësisë për këtë katandisje të vendit dhe varfërim të qytetarit duke ua rrezikuar edhe mbijetesën. Opozita duhet të kundërshtojë në Kuvend, duhet

të protestojë bashkë me qytetarë, nuk duhet të zgjedhë mjete për të ndërprerë këtë keqbërje dhe degradim. Shihni sot kush është në mendermethënë ASHAK? E kaluara antikombëtare dhe jugosllave rri këmbëkryq aty, madje edhe anëtarë të dyshuar të Shërbimit Zbulues dhe Kundërzbulues jugosllavë. Shihni ku i kanë të sistemuar fëmijët dhe familjarët. Analizojeni qeverinë në ikje të Kosovës, gjeni diçka kombëtare aty? Analizoni listën e deputetëve, 48 prej tyre, mund të jenë 4-5 prej tyre që ia vlejnjë. Që kanë trashëguar diçka kombëtare. Thashë qartë se e kanë trashëguar, asgjë më shumë. Shiheni diplomacinë e Kosovës që është shndërruar në qendër të prostitucionit diplomatik e që udhëhiqet nga një injorante gënjeshtare. Dhe thuaja të gjitha ministratë janë të njëjta. E ku janë fëmijët dhe familjarët e të burgosurve politikë dhe luftëtarëve të lirisë?! Me përjashtim të pak rasteve, të gjithë të marginalizuar dhe të përndjekur. Paradoksalisht, edhe nga të vetët edhe nga antikombëtarët e pushtetit aktual. Pushteti, për ta vazhduar sundimin autokratik prodhon kriza të paqena. Sulmon UÇK-në, sistemin prokurorial dhe gjyqësor, Gjykatën Kushtetuese, mediat dhe të gjithë ata që nuk e kanë mendimin e uniformuar si të LV-së. Shpikë rrezik lufte nga Serbia ndonëse e ka të qartë se për aq kohë sa është KFOR-i në Kosovë, nuk ka luftë. Pastaj, kush do të luftojë, Dimal Arsovska, Hekuran paramilitari, Nezir Robinson Kraki, Sipeci apo dezertorët e ndyrë, Haxhi Avdyli, Xhelal Sfeqla dhe Hysen Durmishi. Jo baco, këta kanë bythë vetëm me u mbështetë prapa pushtetit, duke e keqpërdorur pushtetin. Deri më sot asgjë të hajrit nuk kanë bërë për vendin dhe qytetarin. Për

vete po. E njëjtë është Vojsa Osmani që fort e sulmoi Gjykatën Kushtetuese për të fituar pakëz mëshirë nga padroni i saj real, diktatori Kurthi, që bashkë me projugosllavin e thekur Veton Surroi i kanë bërë dëme të pariparueshme Kosovës dhe çështjes kombëtare. Surroi nuk më befason, kumbarën e ka pasur fakultative që i ka ndihmuar të bëhet profiteri më i madh i luftës dhe paqes, politikisht e sidomos materialisht. Veton Surroi dhe Marc Ēelleri ia kanë futur qepën Albin Kurthit me marrëveshjen e Brukselit dhe Ohrit duke siguruar sipas Enver Hasanit autonominë territoriale dhe politike serbëve në Kosovë. Si vlerë e shtuar e kësaj autonomie është futja e arbitrazhit për autonominë e serbëve të cilët nuk e njohin Gjykatën Kushtetuese të Kosovës por institutin dhe autoritetin e arbitrazhit. Prandaj Kurthi përmes cyberzagarëve e sulmon Enver Hasanin. Prandaj prodhon kriza të paqena. Prandaj rreth vetes ka ekskluzivisht injorantë dhe antikombëtarë. Prandaj e sulmon UÇK-në dhe udhëheqësit e luftës. Prandaj mashtron publikisht për raportet e tij me Bacë Adem Demaçin. Dhe shumë prandaj të tjera. Kam shkruar më parë se Albin Kurthi mund të bëhet KM vetëm në livadhet e Dimal Bashës në lagjen pitoreske të Sallahanës në Ferizaj. Sikur që Vojsa Osmani presidente edhe për një mandat, shpresoj në Karkiv të Ukrainës. Kosovën e kanë shpërdoruar, dëmtuar dhe degraduar maksimalisht që të dy, Albin Kurti dhe Vjosa Osmani. Si dyshi famëkeq i Perëndimit të Egër, Boni dhe Kllajd! A do të bëhen pjesë e kabinetit qeveritar të Edvin Ramës, Besnik Tahiri dhe Liburn Aliu. Nesër e merrni vesh, o bektesh!

IKD-JA THOTË SE MINISTRAT E QEVERISË KURTI II USHTRUAN POZITA NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME



Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin mbi qeverisjen e kundërligjshme dhe praktikën e mbajtjes së pozitave me ushtrues detyre gjatë qeverisë Kurti II. Kushtetuta dhe Ligji për Qeverinë ndalojnë qartë që një person të mbajë njëkohësisht pozitën e deputetit dhe të anëtarit të qeverisë. Megjithatë, sipas IKD-së, shumica e anëtarëve të qeverisë në detyrë kanë vazhduar të mbajnë të dy funksionet, duke shkelur Kushtetutën dhe Ligjin. IKD-ja ka vlerësuar se kundërligjshmëria e kësaj praktike është konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme por,

pavarësisht kësaj, qeveria jo vetëm që nuk ka zbatuar vendimin, por ka sulmuar publikisht gjyqtarët e saj. “Moslëshimi i zyrave të qeverisë në detyrë nga personat që janë edhe deputetë të Kuvendit ka pasoja shumë-dimensionale. Pos cenimit të sundimit të ligjit në Kosovë, kjo situatë ka dëmtuar edhe imazhin e Kosovës te partnerët ndërkombëtarë të cilat kanë theksuar se nuk do të zhvillojnë takime me kryeministrin në detyrë dhe ministrat brenda ndërtesës së Qeverisë së Kosovës derisa të jetë në funksion një qeveri me mandat të plotë. Në anën tjetër, në



kuptim të vendimit të Gjykatës Supreme, të gjitha vendimet të

cilat merren nga anëtarët e qeverisë të cilët janë edhe deputetë, janë të kundërligjshme. Në pamundësi për t'u atakuar secili vendim, kjo situatë e mbush rendin juridik me vendime të kundërligjshme. Kjo situatë tërheq pas vetes edhe përgjegjësi penale, e cila aktualisht është duke u shqyrtuar nga PSRK. Për më tepër, kjo situatë rrezikon të ketë implikime edhe në përzgjedhjen e kryetarit të ri të Kuvendit”, ka theksuar IKD-ja. Sipas Institutit të Kosovës për Drejtësi, qeveria Kurti II është karakterizuar me ushtrues detyre. “Një numër i

madh i pozitave janë mbajtur për vite të tëra nga ushtrues detyre, pa u zhvilluar procedurat e rregullta të rekrutimit. Gjykata Supreme ka theksuar se çdo pozitë e mbajtur me ushtrues detyre përtej afatit ligjor është e kundërligjshme dhe vendimet e nxjerra në këto rrethana janë të pavlefshme. Kjo praktikë, e kundërt me standardet ndërkombëtare të qeverisjes së mirë, ka dëmtuar meritokracinë, ka paralizuar funksionimin normal të institucioneve dhe ka rritur potencialin për korrupsion. IKD thekson se mbajtja e pozitave me ushtrues detyre duhet të jetë vetëm përjashtim, ndërsa proceset meritore të rekrutimit duhet të jenë rregull”, është theksuar në reagimin e IKD-së.

22 shërbime të reja për autoshkollë lansohen në platformën e-Kosova

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka lansuar 22 shërbime të reja digjitale në platformën e-Kosova, të cilat i dedikohen sektorit të autoshkollave dhe profesionistëve të përfshirë në

këtë fushë.

Këto shërbime janë pjesë e përpjekjeve për digjitalizimin e shërbimeve publike, duke mundësuar qasje më të lehtë, transparencë dhe efikasitet për qytetarët dhe bizneset që operojnë në fushën e trajnimit të vozitësve.

Shërbimet e reja përfshijnë: Aplikime për licencim dhe rilicencim të autoshkollave,

ligjëruesve profesionalë, instruktorëve të vozitjes dhe pyetësve teorikë/praktikë, kërkesa për ndryshim, ndërprerje të veprimtarisë apo verifikim të angazhimeve, regjistra të detajuar për secilën kategori profesionale etj.

Të gjitha këto shërbime tashmë janë të qasshme online përmes platformës zyrtare: ekosova.rks-gov.net



ZKA-ja: SISTEMI AKTUAL PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE NUK ËSHTË EFEKTIV



PRISHTINË, 10 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka realizuar auditimin e performancës "Efektiviteti i Sistemit për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve në Kosovë" për periudhën 2022-2024 dhe ka vlerësuar trajtimin e

ankesave, planifikimin dhe realizimin e inspektimeve, zbatimin e strategjive dhe programeve, ndërgjegjësimin publik dhe koordinimin ndërinstytucional.

Rezultatet e auditimit tregojnë se, pavarësisht prej përpjekjeve

institucionale, konsumatorët në Kosovë nuk gëzojnë mbrojtje reale, të drejtë dhe efektive, si dhe institucionet nuk arrijnë të garantojnë transparencë dhe përgjegjësi të plotë në këtë drejtim. "Sistemi aktual për mbrojtjen e konsumatorëve nuk

është i koordinuar mirë, dhe paraqet dobësi të theksuara pothuajse në secilën hallkë të tij. Procedurat për trajtimin e ankesave nuk janë të qasshme, të unifikuara dhe nuk monitorohen në mënyrë sistematike e të verifikueshme,

duke pamundësuar sigurimin e një mbikëqyrjeje të besueshme dhe transparente për ecurinë dhe zgjidhjen e rasteve", ka njoftuar ZKA-ja.

Më tutje theksohet se inspektimet kryhen kryesisht pas ankesave individuale dhe jo në bazë të analizës së rrezikut. "Strategjitë dhe planet për mbrojtje të konsumatorëve nuk përcjellën me veprime konkrete e të matshme, ndërsa fushatat për ndërgjegjësim janë të kufizuara dhe nuk arrijnë të gjithë qytetarët. Koordinimi ndërmjet institucioneve është i dobët dhe mungon një sistem i integruar për ndarjen e të dhënave dhe ndjekjen e përbashkët të rasteve", ka njoftuar ZKA-ja.

Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, ka thënë se mangësitë e identifikuara në funksionimin e sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën e qytetarëve për produkte dhe shërbime të sigurt, informim të qartë dhe mekanizma efektivë për mbrojtje.

Për ta rritur efektivitetin e trajtimit të ankesave, forcimin e inspektimeve, rritjen e ndërgjegjësimit dhe koordinimin ndërinstytucional për mbrojtjen e konsumatorëve, ZKA-ja ka dhënë 13 rekomandime.

KEDS-i ua përmirëson jetën mbi 100 banorëve në Maxhunaj të Vushtrrisë

VUSHTRRI, 10 SHTATOR - KEDS-i ka përfunduar me sukses një projekt të rëndësishëm në fshatin Maxhunaj të Vushtrrisë, duke instaluar një transformator të ri me rrjet përcjellës të tensionit të ulët dhe të mesëm. Ky investim ka sjellë një ndryshim të ndjeshëm në cilësinë e shërbimeve energjetike për mbi 100 banorë të kësaj zone, të cilët tashmë gëzojnë furnizim stabil dhe të sigurt. Ky hap përfaqëson vazhdimësinë e përkushtimit të KEDS-it për ta përmirësuar rrjetin elektrik në çdo cep të vendit, duke eliminuar

problemet e mbingarkesave dhe interferimin e faktorëve natyrorë që shkaktonin vështirësi në furnizim.

Ndryshimin madhor pas investimit të KEDS-it e pohojnë edhe konsumatorët e asaj pjese. Nazmi Proni, banor i fshatit, shprehet i kënaqur me këtë ndërhyrje: "Na keni pshtu! Përpara, pajisjet nuk na funksiononin. Tash gjithçka punon qysh duhet. Na keni nxjerrë në dritë", tha Proni, xehetar në KEK, duke përmbledhur ndjesinë e banorëve të shumtë që tashmë përfitojnë nga ky projekt. Projekti është realizuar nga

ekipet e mirëmbajtjes së KEDS-it, të cilat me profesionalizëm kanë përfunduar punimet pa penguar përditshmërinë e banorëve. Vendosja e transformatorit dhe rrjetit përcjellës të ri do të sigurojë një stabilitet afatgjatë në furnizim, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetesës dhe duke ofruar bazë më të mirë për zhvillim ekonomik lokal.

KEDS-i ka njoftuar se mbetet i përkushtuar që me projekte të tilla ta avancojë infrastrukturën energjetike në Kosovë, duke garantuar që çdo konsumator të ketë shërbime moderne, të sigurt dhe të qëndrueshme.



Uran Ismaili premton ndërtimin e Spitalit të Prishtinës

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Kandidati i PDK-së për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka nisur një seri të re takimesh të quajtur "Pa Filter", ku bisedon hapur me qytetarë dhe profesionistë për çështjet më të rëndësishme të kryeqytetit. Në takimin e parë ai u bashkua me Tefik Bekteshin, ish-drejtor i Klinikës së Kardiokirurgjisë. Ismaili tha se qytetarët e Prishtinës janë të diskriminuar prej më shumë se 25 vjetësh nga mungesa e një spitali të

dedikuar për ta, duke theksuar se kjo është padrejtësi e pakuptimtë që duhet të marrë fund. "Kam me e realizu Spitalin e Prishtinës", tha ai, duke kujtuar se plani i hollësishëm është përgatitur që në kohën kur ai ishte ministër i Shëndetësisë, por nuk u vu kurrë në zbatim nga qeverisjet e mëvonshme. Tefik Bekteshi tha se ndërtimi i Spitalit të Prishtinës do të ishte arritje historike për qytetarët e kryeqytetit, duke e cilësuar hap

që do të mbetet në kujtesë. Ai, po ashtu, e falënderoi Ismailin për bashkëpunimin e ofruar gjatë kohës që drejtonte Ministrinë e Shëndetësisë dhe për gatishmërinë për t'i mbështetur profesionistët shëndetësorë në reformat e ndërmarra atë kohë. Ismaili shtoi se qytetarët e kryeqytetit meritojnë shërbime shëndetësore të nivelit më të lartë dhe se Spitali i Prishtinës do të jetë një prej prioritetëve të qeverisjes së tij.



AKTAKUZË NDAJ FARUK MUJKËS PËR KEQPËRDORIM TË DETYRËS

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj Faruk Mujkës - kryeshef i ndërmarrjes "Ibër Lepenci", i dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare në kohën sa ka qenë nënkryetar i komunës së Mitrovicës. Aktakuzë është ngritur edhe ndaj një personi tjetër me inicialet H. M. "Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurve F. M dhe H. M., për veprën penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar'. Të pandehurit akuzohen se, F. M., në pozitën e nënkryetarit të komunës së



Mitrovicës së Jugut, dhe H. M., si drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në të njëjtën komunë, me dashje dhe duke shfrytëzuar detyrën zyrtare, kanë tejkaluar kompetencat me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për persona të tretë dhe në dëm të pronës publike. Sipas aktakuzës, më 25.04.2021, të pandehurit, duke qenë në dijeni se Kuvendi i Komunës kishte marrë dy herë vendim për shpalljen me interes të posaçëm publik të një prone të paluajtshme, i paraqitën po këtij Kuvendi një propozim-vendim për këmbimin e të

njëjtës prone, duke e paraqitur atë si pronë komunale, duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm prej 125 100.00 euro Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Ndërkohë, i pandehuri F. M. akuzohet edhe për veprën penale 'Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare'. Në kuadër të aktakuzës, PSRK ka propozuar: Shqiptimin e dënimeve plotësuese ndaj të pandehurve F.M. dhe H.M", ka njoftuar Prokuroria Speciale e Kosovës.

NËNSHKRUHET MEMORANDUMI PËR EDUKIMIN MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE KOSOVË - IZRAEL

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ilir Muçaj, priti në takim drejtorin e përgjithshëm të Ministrisë për Bashkëpunim Rajonal të Izraelit, Gilad Shadmon, i shoqëruar nga ambasadorja jorezidente e Izraelit në Kosovë, Tamar Ziv. Gjatë takimit u konfirmuan marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Kosovës dhe Izraelit të cilat karakterizohen nga partneriteti i qëndrueshëm dhe bashkëpunimi i frytshëm në fusha të shumta. Palët diskutuan për mundësitë e reja të thellimit të këtij

bashkëpunimi, duke theksuar rëndësinë e inovacionit, sigurisë kibernetike dhe menaxhimit të burimeve ujore si fusha strategjike për zhvillimin e përbashkët. Sekretari Muçaj vlerësoi lart iniciativat e Izraelit që tashmë kanë dhënë rezultate konkrete, si programet e bursave, seminarët e specializuara, projektet për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe përpjekjet për forcimin e lidhjeve mes qytetarëve të dy vendeve. Ai theksoi se këto iniciativa jo vetëm që afrojnë Kosovën dhe Izraelin, por gjithashtu kontribuojnë në rritjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet popujve. Në kuadër të vizitës u nënshkrua



një memorandum mirëkuptimi për edukimin mbi ndryshimet klimatike, mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

(MMPHI) dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal të Izraelit. Ky memorandum synon ndërgjegjësimin e gjeneratave të reja dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale në këtë fushë. Po ashtu, të dyja palët shprehën

gatishmërinë për ta zgjeruar partneritetin përtej klimës dhe edukimit, duke eksploruar mundësi të reja bashkëpunimi në: tregti dhe investime, me theks të veçantë në teknologji, inovacion dhe ekosistemet e start-up-ve, ku Kosova dhe Izraeli kanë potencial të madh zhvillimi, në siguri kibernetike, si dhe në bujqësi dhe menaxhim të ujit, duke u mbështetur në përvojën botërore të Izraelit dhe në nevojat zhvillimore të Kosovës. Ky takim shënon një hap tjetër të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve bilaterale, duke vendosur bazat për projekte konkrete që do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe prosperitetin e dy vendeve.

Sallahu viziton zyrën rajonale të shërbimit sprovues në Pejë

PEJË, 10 SHTATOR - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu, bashkë me drejtorin Arsim Tahiri vizituan Zyrën Rajonale të Shërbimit Sprovues në Pejë, me ç'rast u pritën nga drejtoresha Drita Hakaj. Gjatë takimit u diskutua për sfidat dhe nevojat e

shërbimit sprovues, me theks të veçantë në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e kushteve të punës për stafin. Ministri Sallahu u informua nga afër lidhur me rezultatet dhe sfidat të kësaj Qendre. Ai më tej theksoi se gratë në pozita udhëheqëse po dëshmojnë se menaxhimi

efikas dhe qeverisja gjithëpërfshirëse ecin krah për krah duke sjellë rezultate shumë pozitive. Sallahu siguroi mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Drejtësisë për t'i adresuar sfidat dhe për ta forcuar rolin e shërbimit sprovues në sistemin tonë të drejtësisë.



MILIONAT MBETEN PA U SHFRYTËZUAR, POR BUXHETET KOMUNALE RRITEN

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Trotuaret e bllokuara, mbeturinat dhe mungesa e hapësirave publike e bëjnë jetën e përditshme në Fushë-Kosovë një sfidë të përditshme për qytetarët. “Lirshëm mund të ecësh vetëm nëpër hekurudhë, kur nuk kalon treni, sepse tjetërkund nuk ka hapësirë për këmbësorë”, thotë Rafet Berisha, banor i kësaj komune në pjesën qendrore të Kosovës. Ai tregon për “Radion Evropa e Lirë” se trotuaret janë të bllokuara nga makinat, ndërsa grumbuj mbeturinash shihen pothuajse në çdo lagje.

Të njëjtin shqetësim e ndan edhe Sara, nënë e trinjakëve në klasë të tetë. Ajo thotë se çdo ditë i shoqëron fëmijët e saj për në shkollë dhe mbrapsht, sepse nuk ndihet e sigurt t’i lë vetëm. “Ne ecim anës rrugës kryesore, sepse trotuaret janë të zëna. Kjo është rrezik për fëmijët. E, përveç makinave, ka edhe shumë qen endacakë”, thotë ajo teksa pret fëmijët para Shkollës Filllore “Mihail Grameno”.

Për hapësira rekreative në Fushë-Kosovë banorët thonë se as nuk bëhet fjalë. “Këtu nuk ke park, as lodra për fëmijë”, thotë Zeqir Kryeziu. “Këtu i blen gjërat e nevojshme dhe kthehesh në banesë, nëse nuk do që të hysh në ndonjë restorant”, shprehet ai. Me mbi 64 mijë banorë, Fushë-Kosova është komuna e nëntë më e populluar në Kosovë. Por, edhe pse nevojat për infrastrukturë janë të dukshme, vitin e kaluar ajo e përfundoi me suficit buxhetor njësoj si vitin paraprak. Për vitin 2024 komuna kishte në dispozicion mbi 16 milionë euro nga buxheti i shtetit dhe mbi 6.3 milionë euro të bartura nga viti paraprak.

Nga rreth 23 milionë euro gjithsej u shpenzuan 88 për qind, ndërsa të pashpenzuara mbeten rreth 2.8 milionë.

Pse vazhdimisht teprojnë mjete?

Nënkryetari i komunës, Besnik Osmani, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se projektet ekzistojnë, por zbatimi i tyre



vonohet për një sërë arsyesh - nga kushtet atmosferike dhe çështjet pronësore, deri te koordinimi me institucionet e tjera. “Ne kemi lëndë që presin tetë ose nëntë muaj për përgjigje, e kjo nënkupton se mbeten vetëm tre muaj për zbatim të projektit”, shpjegon ai. Osmani pranon se përqindja e shpenzimeve “nuk është e shkëlqyer”, por thotë se “është e qëndrueshme”. Në mesin e projekteve të realizuara vitin e kaluar ai përmend ndërtimin e dy shkollave fillore dhe disa rrugëve, ndërsa shton se për shqetësimet e tjera të qytetarëve “po punohet”.

Pesëdhjetë e tetë milionë euro tepricë

Fushë-Kosova, megjithatë, nuk është e vetmja komunë që vitin e kaluar e mbylli me suficit buxhetor, pavarësisht prej nevojave të qytetarëve për shërbime më të mira publike. Në nivel vendi komunat shpenzuan mesatarisht 93 për qind të buxhetit, ndërsa rreth 58 milionë euro mbeten të pashfrytëzuara, thotë Blendi Hasaj, drejtor ekzekutiv i Institutit për Hulumtime të Avancuara - GAP, që ka analizuar menaxhimin e financave

komunale.

Përveç arsyeve të përmendura nga Osmani, Hasaj thekson se komunat përballen edhe me mungesë stafi në zyrat e prokurimit dhe monitorimit të projekteve kapitale, si dhe me vonesa nga operatorët privatë që nuk i përfundojnë punimet në kohë.

Këto pengesa ngadalësojnë, pastaj, zbatimin e investimeve në rrugë, çerdhe, ujësjellës dhe hapësira publike, ndërsa koston e tyre e paguajnë qytetarët. “Paramendoni se sa investimet do të mund të bëheshin me këto mjete [të pashfrytëzuara], të cilat do të ndiknin drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve”, thotë Hasaj për “Radion Evropa e Lirë”.

Rritja e popullsisë rrit edhe buxhetin në komuna

Me gjithë tepricat, disa komuna pritet të përfitojnë vitin e ardhshëm edhe rritje të konsiderueshme të buxhetit - disa deri në 60% krahasuar me vitin aktual. Megjithatë, kjo rritje lidhet me rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Parashikimet janë pjesë e Qarkores buxhetore 2026/02 për

Komuna, e përgatitur nga Ministria e Financave si udhëzues për hartimin e buxhetit të vitit të ardhshëm.

Sipas këtij dokumenti, buxheti i përgjithshëm i shtetit për vitin 2026 pritet të arrijë në rreth 3.5 miliardë euro, ndërsa buxheti i dedikuar për komunat do të jetë 867 milionë euro. Një nga kriteret kryesore për shpërndarjen e këtyre mjeteve dhe granteve qeveritare nëpër komuna është numri i banorëve.

Si e ndryshoi regjistrimi i popullsisë buxhetin?

Sipas rezultateve të ASK-së, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë është 1.585.590 nga 1.739.825 sa ishte në vitin 2011, kur u realizua regjistrimi paraprak. Edhe pse popullsia totale ra, disa komuna shënuan rritje të numrit të banorëve. Prishtina dhe Fushë-Kosova është shembulli më i qartë. Kryeqyteti shënoi rritje nga 198.897 banorë në vitin 2011 në 227.466 në regjistrimin e fundit - rreth 28.569 më shumë. Kjo u reflektua edhe në buxhet, i cili do të rritet nga mbi 128 milionë euro këtë vit në 151 milionë euro vitin e ardhshëm - një rritje kjo prej rreth 23%. Rritjen më të madhe buxhetore do ta ketë Fushë Kosova, ku

popullsia u rrit për dhjetëra mijëra banorë, por edhe Shtërpca.

Nënkryetari i Fushë Kosovës, Besnik Osmani, thotë se mungesa e regjistrimit të popullsisë dhe rritja e saj gjatë një dekade i kanë kushtuar komunës dhjetëra miliona euro humbje. “Nga viti i ardhshëm do të kemi gati dyfishim të buxhetit, që do të thotë se, mesatarisht, gjatë dhjetë vjetëve të fundit, komuna e Fushë Kosovës ka humbur 53 deri në 54 milionë euro”, thotë ai. Megjithëse në disa komuna u shënuar rënie e numrit të banorëve, Qarkorja buxhetore nuk parashikon ulje të buxhetit krahasuar me vitin 2025.

Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, e konfirmoi në një postim në “Facebook” rritjen e buxhetit të Prishtinës në 151 milionë euro. Ai e përshkroi këtë ndryshim si “kapërcim enorm” krahasuar me vitin 2021, kur kryeqyteti i ishin ndarë rreth 87 milionë euro buxhet, por pranoi se për vitin 2026 “është marrë për bazë regjistrimi i fundit i popullsisë”. Postimet e tij nuk kaluan pa reagime - qoftë për ta përgëzuar, ose kritikuar.

Njëri prej komentuesve, Andi Bytyqi, shkroi se “buxheti i qytetarëve përdoret si instrument fushate” dhe jo si “mjet për përmirësimin e jetës së përditshme të tyre”.

“Çka nëse nuk fiton kandidati i preferuar i juaj? Atëherë nuk do të ndahet buxheti i lartpërmendur?”, pyeti ai, por në postimin e tij nuk pati përgjigje. Kosova është në prag të zgjedhjeve lokale të tetorit, kur në garë do të jenë të 38 komunat e vendit.

Nga anketat që ka zhvilluar “REL”-i gjatë vitit, ankesat kryesore të qytetarëve lidhen me çmimet e larta të produkteve të konsumit, por edhe me çështje të tjera - nga mungesa e çerdheve deri te mbingarkesa e trotuareve. Se si do të reflektohet rritja buxhetore në standardin e jetesës dhe cilësinë e shërbimeve për ta, mbetet për t’u parë, por përvoja tregon se përmirësimet vijnë ngadalë.

Hyseni: Synimi ynë është ndërtimi i një dialogu të hapur dhe të vazhdueshëm me komunitetin e bizneseve

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Mentor Hyseni, me bashkëpunëtorë, mori pjesë në Forumin Vjetor të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Në fjalën e tij, Hyseni tha se është kënaqësi e veçantë të jetë pjesë e këtij takimi të parë të përbashkët, ku synimi ynë kryesor është ndërtimi i një dialogu të hapur dhe të vazhdueshëm ndërmjet Administratës Tatimore të Kosovës dhe komunitetit të bizneseve.

Më tutje ai shtoi se jemi të vetëdijshëm se zëri i bizneseve është jetik për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e klimës së të bërit biznes në vend. Pikërisht për këtë arsye, dëshiroj t’ju njoftoj më për së afërmi me disa nga ndryshimet kryesore që janë bërë në Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë te bizneset tuaja.

Drejtori i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, vlerësoi

bashkëpunimin e vazhdueshëm me Administratën Tatimore të Kosovës, duke theksuar nevojën për dialog të hapur dhe partneritet me komunitetin e biznesit.

Drejtori Hyseni i premtoi komunitetit të bizneseve se ATK-ja mbetet e përkushtuar të jetë administratë më transparente, më moderne dhe më afër tatimpaguesve, duke ndërtuar së bashku një ambient më të favorshëm për zhvillim ekonomik.



AEROPLANI DHE SPIUNI I CIA-S QË RANË NË RUSI NË VITIN 1960

Nga: Nicholas BARBER / BBC

Francis Gary Powers ishte në një mision spiunazhi të CIA-s, mbi Rusinë sovjetike, kur aeroplani i tij U-2 u godit nga një raketë tokë-ajër. “Shikova lart, shikova jashtë, dhe gjithçka ishte portokalli, kudo”, ka thënë Powers. “Nuk e di nëse ishte reflektimi në xhamin e kabinës apo thjesht i gjithë qielli. Dhe, më kujtohet që i thashë vetes: ‘Pasha Zotin, e pata puna ime’”.

Në fakt, Powers arriti të hidhej me parashutë dhe të shpëtonte, por telashet për të sapo kishin filluar. Pasi u arrestua dhe u mor në pyetje nga KGB-ja, ai u nxor në gjyq në Moskë, ku familja e tij mund ta shihte, pa mundur që ta ndihmonte. “Tha se e dinte që ne ishim të pranishëm në gjyq”, tregoi bashkëshortja e tij, Barbara Powers për BBC. “Më ka parë teksa ia bëra me dorë. Dhe, tha se nuk mundej ta kthente shikimin drejt kutisë ku ishim ulur, sepse kjo e trondiste shumë, dhe ai e dinte që do të na trondiste edhe neve”. Më 19 gusht 1960, 65 vjet më parë, Powersi u dënua me 10 vjet burg - tre në një burg rus dhe shtatë në kamp pune. Kapja dhe gjyqi i tij kishin ndikim të madh në marrëdhëniet Lindje-Perëndim në kulmin e Luftës së Ftohtë.

Powers ishte 30 vjeç në atë kohë. Ishte djali i një minatori qymyri nga Kentaki i ShBA-së, ndërsa studioi për kimi dhe biologji përpara se të bashkohej me Forcat Ajrore të ShBA-së në vitin 1950. Në vitin 1956, u rekrutua nga CIA për të pilotuar aeroplanët U-2 të spiunazhit - mbi territoret armike. Këta aeroplanë mund të fluturonin në 70 mijë këmbë (21.3 kilometra), gjë që mendohej se ishte mbi rrezen e mbrojtjes sovjetike, ndërsa kamera e avancuar në bord mund të bënte fotografi të detajuara të instalimeve ushtarake. Më 1 maj 1960, Powers u ngrit nga Peshavari në Pakistan, me misionin të fluturonte mbi Bashkimin Sovjetik dhe të aterronte në Norvegji. “Rruga e planifikuar do të na çonte më thellë se kurrë më parë në Rusi, duke kaluar mbi objektiva të rëndësishëm që nuk ishin fotografuar kurrë”, shkroi ai në kujtimet e tij, Operation Overflight.

Por, autoritetet sovjetike kishin zbuluar fluturimet e mëparshme të U-2-ve dhe ishin të vendosur ta ndalonin këtë, me çdo kusht. Aeroplanë luftarakë MiG-19 u ngritën, dhe raketat S-75 Dvina u lëshuan. Katër orë pas nisjes së misionit, aeroplani i Powersit u godit nga njëra prej këtyre raketave pranë qytetit rus Sverdlovsk (tani Jekaterinburg). Njëri nga krahët e aeroplanit u shqye, dhe mjeti filloi të rrotullohej e të binte drejt tokës. I biri i Powers, Gary Powers Jr., e



tregoi këtë ngjarje në podkastin Witness History të BBC-së. “Mendoj të hidhej jashtë - kjo është gjëja e parë që mësojnë pilotët, që të dalin nga aeroplani nëse dëmtohet apo është i paaftë për fluturim. Por, ai e kuptoi se, nëse hidhet, do t'i këputen këmbët në dalje. Kabina e U-2-shit është shumë e vogël, shumë e ngushtë, shumë e përmbledhur. Që të hidhesh, duhet të jesh në pozicionin e përkryer për të kaluar larg strukturës së aeroplanit, përndryshe mund të humbasësh ndonjë gjymtyrë”. Zgjidhja e Powersit ishte të mos përdorte ulësen e shpëtimit: ai do ta hapte thjesht kapakun e kabinës dhe do të dilte jashtë. Por, sapo e hapi kapakun, u bllokua në dalje dhe nuk arriti të shtypte butonin e vetëshkatërrimit në panelin e U-2-shit. “Ai ende ishte i lidhur me tubin e oksigjenit, kështu që ja ku është, gjysmë e trupit brenda aeroplanit, gjysmë jashtë, duke u rrotulluar drejt tokës, duke humbur dhe rikthyer ndjenjat, duke u përplasur përbrenda”. Disi, Powers arriti të çlirohej nga U-2-shi dhe u hodh me parashutë mbi një fermë kolektive në periferi të Sverdlovskut. Por, kishte vënë re tashmë një makinë të zezë që e ndiqte nga rruga poshtë, tekta zbriste. Zyrtarët e sigurimit të shtetit e kapën shpejt. Ata gjithashtu kishin mbeturinat e aeroplanit U-2, përfshirë edhe kamerën e tij.

Problemi për qeverinë amerikane ishte se nuk kishin asnjë mënyrë për të ditur nëse Powersi kishte mbijetuar, dhe asnjë mënyrë për të ditur nëse U-2-shi ishte vetëshkatërruar. Departamenti i Shtetit lëshoi një histori mbuluese, duke pretenduar se Powersi kishte

qenë duke fluturuar mbi Turqi, duke studiuar modelet e motit për NASA-n kur kishte hyrë aksidentalisht në hapësirën ajrore sovjetike. Madje, historia përfshinte fotografi të një U-2-shi me një logo të NASA-s. Por, në vend që ta mbante misionin sekret, kjo përpjekje e nxituar për mashtrim e shndërroi atë në një turp të madh publik.

Kryeministri i Bashkimit Sovjetik, Nikita Khrushchev, njoftoi botën se Powersi ishte gjallë dhe shëndoshë - dhe se kamera dhe fotografitë e tij ishin gjetur të paprekura, duke treguar se ai ishte spiun. I detyruar të pranonte se kishte gënjyer, presidenti amerikan, Dwight D. Eisenhower, reagoi me nervozizëm duke pretenduar se ShBA-ja kishte të drejtë të mbante nën vëzhgim armikun. Koha ishte e papërshtatshme, pasi të dy burrat do të merrnin pjesë në një konferencë në Paris përkrah krerëve të qeverive franceze dhe britanike. Ky ishte samiti i parë pas pesë vjetësh me pjesëmarrjen e liderëve sovjetikë dhe amerikanë, dhe shpresohej që do të përmirësonte miqësinë përtej Perdes së Hekurt. Skandali i Powersit e bëri këtë të pamundur.

“Z. Khrushchev donte të kërkimfalje [nga amerikanët] para se të nisnin bisedimet”, raportoi BBC më 17 maj. “Ai gjithashtu tha se ShBA-ja duhet të premtojë se nuk do të shkel më hapësirën ajrore sovjetike dhe se do të ndëshkonte gjithë përgjegjësit për incidentin. Presidenti Eisenhower i hodhi poshtë kërkesat, duke lënë samitin e paqes tërësisht të rrënuar ... Të dy palët fajësojnë njëra-tjetrën për dështimin e konferencës”. Powers gjithashtu u detyrua të mbante pjesërisht përgjegjësinë për këtë katastrofë

diplomatike.

Kur u nxor në gjyq në Moskë në gusht, gazetari i BBC-së, Ian McDougall, e përshkroi atë si “një njeri çuditërisht naiv ... një burrë i frikësuar me shpinën për muri ... i cili e dështoi misionin ... nuk ishte shumë trim ... dhe ndiqte qartë nga afër sugjerimet e avokatit të tij mbrojtës rus”.

Fatmirësisht për Powersin, ai u lirua dy vjet më vonë, në vitin 1962. Sipas një raporti të BBC-së, radioja sovjetike e paraqiti lirimin e tij si akt mëshire “në përgjigje të kërkesës së prindërve dhe të afërmve të Powersit, dhe për shkak të pranimi të ndershëm të fajësisë së tij të rëndë”. Në të vërtetë, Powers u dërgua në shtëpi në këmbim të një agjenti të KGB-së të ndaluar në ShBA, William Fisher, i njohur si Rudolf Abel. Ky shkëmbim i të burgosurve do të bëhej subjekti i filmit Bridge of Spies të Steven Spielbergut, i publikuar në vitin 2015 - megjithëse Powers, i luajtur nga Austin Stowell, ishte personazh dytësor. Në vitin 1962, një ekspert spiunazhi, Bernard Newman, i tha BBC-së se Bashkimi Sovjetik kishte dalë më i fituar nga ky shkëmbim sesa ShBA-ja. Abeli ishte spiun i trajnuar dhe me njohuri të thella, ndërsa “Powersi ishte pilot shumë i mirë, por nga këndvështrimi i spiunazhit, gjithçka që dinte ishte të shtypte disa butona”.

Disa nga mediat ishin edhe më të ashpra, pasi shumë komentatorë amerikanë e panë Powersin si frikacak dhe, ndoshta, edhe tradhtar. “Editoriale të tëra ishin shkruar gjatë kohës kur ai ishte në burg”, tha Gary Jr. “Këto editoriale në shtypin amerikan dhe britanik thoshin, në thelb, se ai kishte dezertuar. Se e kishte ulur aeroplanin pa e shkatërruar, se i kishte treguar sovjetikëve

gjithçka që dinte ose se nuk kishte ndjekur urdhrat ... të gjitha këto ishin pjesërisht të vërteta, të pavërteta, disa ashiqare gënjeshtra dhe aludime”. Teoritë konspirative sillëshin rreth faktit se Powersi nuk shtypi butonin e vetëshkatërrimit të U-2-shit dhe se u lejua të arrestohej në vend që të vetëvritej. “Por, babait tim, nuk i bënte përshtypje kjo”, tha Gary Jr. “Nuk i interesonte çfarë mendonin të tjerët se duhej apo nuk duhej të kishte bërë”.

Autoritetet amerikane bënë disa përpjekje për të rikthyer reputacionin e Powersit. Ai u vlerësua për trimërinë e tij nga disa senatorë - pas paraqitjes në Komisionin e Shërbimeve të Armatosura të Senatit në vitin 1962 - dhe në vitin 1965 iu nda Ylli i Inteligjencës nga CIA. Pasi u shkurorëzua dhe u martua sërish, punoi si pilot testues për [kompaninë] Lockheed, pastaj si pilot helikopteri për një stacion lajmesh televizive në Los Anxhelos, KNBC Channel 4. Por, u vra gjatë këtij profesioni, kur helikopteri i tij u rrëzua në vitin 1977.

Gary Jr ishte vetëm 10 vjeç në atë kohë, prandaj kishte shumë gjëra që nuk i dinte për misionet e të atit. Ai mori vetë përsipër t'i hulumtonte ato dhe, më në fund, në vitin 1996 ishte bashkëthemelues i Muzeut të Luftës së Ftohtë në Uarenton të Virxhinias, për të ruajtur historinë e Powersit dhe të të tjerëve si ai. “Si fëmijë, u rrita duke ditur që babai im ishte rrëzuar në Bashkimin Sovjetik, se ishte burgosur nga KGB-ja dhe më në fund ishte shkëmbyer me një spiun sovjetik”, tha Gary Jr. “Por, si fëmijë, kjo më dukej krejt normale. Ishte diçka për të cilën flisnim. Mendoja se çdo fëmijë kishte një baba që kishte kaluar diçka të tillë”. //Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Rexhbeçaj: Krenaria jonë është më e fortë se urrejtja e gojëligëve

Mesfushori Elvis Rexhbeçaj e shënoi golin e parë me fanellën e Kombëtares së Kosovës kundër Suedisë në stadiumin

“Fadil Vokrri” në garë për kualifikim në Kupën e Botës 2026. Ai në rrjetet sociale ka përcjellë një mesazh, duke

theksuar se fitoret si ajo ndaj Suedisë janë më shumë se një rezultat. “Janë shpirt, zemër e gjak për këtë vend”, ka shkruar

ai. “Krenaria jonë është më e fortë se urrejtja e gojëligëve. Kosova gjithmonë ngrihet dhe lufton për fitore. Fitojmë

bashkë, humbim bashkë, gjithmonë një zemër, një ekip!”, ka shkruar Elvis Rexhbeçaj në “Instagram”.

SHAQIRI RRËFEN PËR PËRVOJAT NË INTER, BAYERN, LIVERPOOL DHE KTHIMIN NË BASEL

BAZEL, 10 SHTATOR - Xherdan Shaqiri ka lënë gjurmë kudo ku ka luajtur. Sot konsiderohet futbollisti më i madh që ka përfaqësuar Zvicrën. Në një intervistë për “Gazzetta.it”, Shaqiri ka folur hapur për gjashtë muajt e tij të vështirë në Milano, keqardhjet për Juventusin dhe kthimin në shtëpi, ku ka rizbuluar lumturinë dhe fitoret. Historia e Xherdan Shaqirit është një pasqyrë e brezit të tij. Ai lindi në Kosovë nga prindër shqiptarë, të cilët më vonë emigruan në Zvicër për një jetë më të mirë. U bë qytetar i botës që në fëmijëri dhe vazhdoi të udhëtonte gjatë gjithë karrierës: gjashtë vende, shumë gjuhë të ndryshme dhe një mori përvojash. Sot, në moshën 33-vjeçare, ai e ka gjetur lumturinë në Basel, qytetin ku u kthye pas 15 sezonesh duke bledhur nëpër botë. Dhe aty fitoi sërish, që në përpjekjen e parë. Gjatë këtij udhëtimi të gjatë, ndaloj edhe në Itali, në një përvojë gjashtëmujore jo të lumtur në Milano. Sot në Zvicër ai është përsëri i gëzuar: një profet në vendin e tij.

Jeni rikthyer në Basel dhe fituat kampionatin që në sezonin e parë. A është Xherdani i lumtur përsëri?
Shaqiri: Po, shumë. Dhe nuk dua të ndalem. Falë Baselit, kam rizbuluar motivimin dhe buzëqeshjen time. Ndihej si një gjeni i çmendur. Sezoni i kaluar tregoi se ende kam cilësinë për të bërë diferencën.

Lëndimet ju kanë shoqëruar shpesh gjatë karrierës. Një fatkeqësi konstante që ju ka penguar?
Shaqiri: Kush e di se çfarë karriere do të kisha pasur po të mos ishin problemet fizike. Vitet e fundit kanë qenë shumë të vështira. Por tani, në Zvicër, jam përsëri mirë dhe i lumtur.

Le të kthehemi pas. Në vitin 2015 mbërritët në ‘San Siro’, i sjellë nga



Interi. Mançini ju kishte zgjedhur personalisht. Si shkoj ajo periudhë?
Shaqiri: Interi më kishte ndjekur për një kohë të gjatë. Mançini më telefonoi dhe më bindi brenda pesë minutash. Më tha se do të isha në qendër të projektit, por në fund nuk luajta shumë. Sigurisht, edhe problemet fizike ndikuan. Megjithatë, duke parë gjithçka, mendoj se mund të më kishin dhënë pak më shumë minuta.

Keni fituar kudo, përveçse në Milano. Çfarë lloj Interi gjetët atëherë?
Shaqiri: Rashë në një nga skuadrat më të dobëta të Interit në 15 vitet e fundit. Ishim një ekip i ndërtuar keq, pa ekuilibër dhe, singulisht, edhe pa asnjë kampion të madh. Më ishte premtuar shumë hapësirë, por prisja një mjedis ndryshe. Nuk kishim lojtarë të mëdhenj dhe nuk ishim të ndërtuar për të fituar.

Po dhoma e zhveshjes, si ishte?
Shaqiri: Një grup i shkëlqyer, duhet ta pranoj. Edhe pse atmosfera nuk ishte gjithmonë e qetë, e dini vetë... kur nuk fiton

shpesh. Por ne argëtoheshim. Kalova shumë kohë me Kuzmanoviqin, të cilin e kisha njohur që në ekipin e të rinjve të Bazelit. Pastaj kujtoj me nostalgji shumë të tjerë: Nagatomon, Juan Jesus, Dodon.

Po Mançini? A do t'i thoshit diçka sot?
Shaqiri: Ai mund të më kishte aktivizuar më shumë (qesh)... por kam shumë respekt për të si trajner. U takuam edhe me kombëtaren dhe gjithmonë kishte fjalë të mira për mua.

A është e vërtetë që ju dërguan te një mjek “special” për trajtim?
Shaqiri: Më shumë shaman se sa mjek. Më thanë të shkoja tek një person që bënte mrekulli, që madje kishte shëruar edhe Ronaldon, Fenomenin. Mançini më tha të njëjtën gjë. Por ishte një përvojë katastrofike. Udhëtova një orë e gjysmë dhe nuk pata asnjë përfitim.

Mbërritët në Itali në janar 2015. A kishte ndonjë mundësi më herët?
Shaqiri: Mund të kisha qenë numri 10 i Juventusit disa vite më parë. Ata donin që unë të

zëvendësoja Diegon, mesfushorin sulmues. Te Bayerni nuk po luaja shumë dhe isha i hapur për transferim. Por nuk ndodhi asgjë. Do të më kishte pëlqyer, por në fund gjithçka doli mirë: tani në Itali mbështes Interin.

A e ndiqni ende futbollin italian sot? Si e shihni Interin në garën për ‘Scudetton’?
Shaqiri: Interi është një skuadër e shkëlqyer dhe si e tillë duhet gjithmonë të synojë të fitojë. I kanë mbajtur yjet dhe janë forcuar. Duhet të shkojnë deri në fund në të gjitha garat. Është e vërtetë që kanë ndërruar trajner, por unë jam i sigurt: mund ta fitojnë “Scudetton”. “San Siro” është një vlerë e shtuar. E mbaj mend si një stadium fantastik, mbresëlënës kur është plot.

Duke folur për trajnerë, keni pasur shumë. Kush ishte më i miri?
Shaqiri: Guardiola është më i miri në aspektin taktik dhe të organizimit të lojës. Ai u përpoq të revolucionarizonte futbollin në Gjermani dhe te Bayerni, dhe mendoj se ia doli. Kam pasur

shumë trajnerë të mirë. Dua të përmend edhe Ottmar Hitzfeld, një njeri të vërtetë, me të cilin jam shumë i lidhur. Një trajner i një epoke tjetër.

Po shokët e skuadrës? Keni luajtur me kampionë të mëdhenj, sidomos te Bayerni dhe Liverpooli. Kush ju ka lënë më shumë mbresa?
Shaqiri: Është e vështirë të veçoj një. Kam luajtur me shumë lojtarë të jashtëzakonshëm. Por nëse duhet të zgjedh, do të thosha Ribery. Ai luante në rolin tim dhe më mahniti që nga stërvitja e parë. Jashtë fushe ishte i qetë dhe gjithmonë buzëqeshte, por në fushë shndërrohej në një bishë. Çfarë driblimi, çfarë cilësie. Franck është një nga njerëzit më të mirë që kam takuar ndonjëherë në futboll.

Kapitulli i kombëtares. Ju jeni një simbol i Zvicrës. Çfarë do të thotë kjo për ju dhe familjen tuaj?
Shaqiri: Zvicra dhe Kosova janë vendet më të afërta me zemrën time; ato tregojnë historinë time dhe atë të familjes sime. Të veshësh fanellën e Zvicrës është një nder dhe privilegj, ashtu si të shënosh në Kampionatin Evropian apo në Kupën e Botës. Për mua është shtëpi, familje, kujtime. Luaj edhe për prindërit e mi.

Tani që jeni përsëri i lumtur me Basel, a keni menduar ndonjëherë të tërhiqeni? Dhe ku e shihni veten pas futbollit?
Shaqiri: Jo, nuk po mendoj për këtë. Jam 33-vjeçar dhe ende kam një dëshirë të fortë për të pushtuar botën dhe për të provuar veten. Dua të fitoj dhe të arrij edhe më shumë. Pas futbollit, e shoh veten në biznes. Kam filluar tashmë disa projekte, por futbollit është ende fokusi im kryesor. Dua të tregoj se jam ende një gjeni i çmendur. Kam ende shumë për të dhënë.

Shqipëria më 14 tetor zhvillon miqësore me Jordaninë

Kombëtarja e Shqipërisë do të zhvillojë një ndeshje miqësore në muajin tetor kundër Jordanisë. Federata e Futbollit ka arritur

marrëveshjen me homologët jordanëzë që takimi të luhet më 14 tetor në stadiumin “Air Albania” në orën 19:00. Kjo do të jetë përballja e dytë në

histori mes dy ekipeve përfaqësuese. Sfida e parë është zhvilluar më 10 tetor 2018 në “Elbasan Arena” dhe është mbyllur në barazim pa

gola. Data 14 tetor është e lirë sipas kalendarit të FIFA-s, pasi Shqipëria bën pjesë në një grup me pesë ekipe në kualifikueset e Botërorit

2026. Po në këtë muaj, kuqezinjtë do të zbresin në fushë edhe për ndeshjen kualifikuese ndaj Serbisë në Beograd.

Leon Dajaku nënshkruan për SSV Ulm

ULM, 10 SHTATOR - Leon Dajaku rikthehet në Gjermani, por kësaj radhe do të luajë në Bundesliga 3. 24-vjeçari ka firmosur kontratë me SSV Ulm 1846 deri më 30 qershor 2027, duke u bërë përforcimi më i ri i klubit gjerman. Dajaku ka përvojë të madhe për moshën e tij, me gjashtë paraqitje në

Bundesligë, 43 ndeshje në divizionin e tretë dhe 32 takime në kampionatin anglez. Ai ka provuar edhe futbollin në Zvicër, Kroaci dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Sulmuesi nga Kosova ka luajtur 24 herë për ekipet kombëtare të të rinjve të Gjermanisë. Ai u rrit te VfB Stuttgart dhe në vitin 2019 u

transferua te Bayern Munichu, me të cilin fitoi dopietën në vitin 2020. Pas Bayernit, ai kaloi tek Union Berlini dhe më pas te Sunderlandi në Angli. Karriera e tij vijoi me St. Gallenin në Zvicër, Hajduk Split në Kroaci dhe së fundmi Sharjah FC në Emiratet e Bashkuara. “Jam i kënaqur që

po marr një sfidë të re në një klub tradicional si SSV Ulm 1846. Gjithashtu tani jam shumë afër qytetit tim të lindjes dhe familjes sime përsëri. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për mua dhe dua t’i shfrytëzoj sa më mirë cilësitë e mia në mënyrë që të kemi sukses së bashku”, ka deklaruar Dajaku.



FIFA pritet ta ndëshkojë rëndë Serbinë, ndaj Shqipërisë mund të luhet pa tifozë në Beograd

Tiranë, 10 shtator - Kombëtarja e Serbisë rrezikon një dënim të ashpër nga FIFA, pas ngjarjeve të ndodhura gjatë ndeshjes me Anglinë në Beograd, e vlefshme për kualifikueset e Botërorit 2026. Në aspektin sportiv, Serbia pësoi një humbje të rëndë 0-5 përballë anglezëve, me golat e Harry Kane, Noni Madueke, Ezri Konsa, Marc Guehi dhe Marcus Rashford (nga penalltia). Por më problematike për Federatën Serbe të Futbollit janë incidentet e ndodhura në tribuna. Sipas medieve britanike, veçanërisht portalit “Sportbible”, sjellja e tifozëve serbë mund t’i kushtojë Serbisë sanksione të rënda. Në stadium u shfaq një banderolë me mesazhin “Kosova është zemra e Serbisë”, ndërsa u dëgjuan edhe kore mbi Kosovën dhe Metohinë. Këto veprime kanë nxitur reagime nga autoritetet në Kosovë, të cilët



kërkuan nga FIFA dhe UEFA masa të menjëhershme. Ndeshja u ndërpre për pak minuta pasi një lazer u drejtua në fytyrën e mbrojtësit anglez Ezri Konsa, ndërsa spikeri i stadiumit u detyrua ta paralajmëronte publikun për ndalimin e përdorimit të lazerëve dhe piroteknikës. Gjithashtu, raportohen raste ku tifozët

përdorën fishkëllima artificiale për t’i hutuar lojtarët në fushë. Problemet nuk munguan as në tribuna, ku policia ndërhyri për të qetësuar grupime tifozësh që nisën të këndonin këngë kundër qeverisë serbe. FIFA dhe UEFA ende nuk kanë dalë me një komunikatë zyrtare, por pritet që Serbia të përballet me gjoba të majme dhe mbyllje të stadiumit për ndeshjet e ardhshme. Një dënim i tillë mund të bënte që Serbia ta priste Shqipërinë pa tifozë më 11 tetor në “Rajko Mitić”, përcjell “KohaJone”. Edhe ish-gjyqtari i njohur anglez, Keith Hackett, paralajmëroi pasoja: “Përdorimi i lazerëve është i rrezikshëm dhe i papranueshëm. Raporti i arbitrit francez Clement Turpin dhe i vëzhguesit do t’i shkojë FIFA-s. Serbia do të marrë një dënim të rëndësishëm”, u shpreh ai për “Football Insider”.

Sylvinho: Krenar për lojtarët, tani të përgatitemi për Serbinë

TIRANË, 10 SHTATOR - Trajneri i Kombëtares shqiptare, Sylvinho, analizoi fitoren 1-0 ndaj Letonisë në “Air Albania”, duke e cilësuar një ndeshje të vështirë për shkak të forcës fizike të rivalëve dhe mungesës së golit të dytë. Ai foli për ndryshimet në formacion, rolin e Brojës, rikthimin e Bajramit si dhe kontributin e Asllanit, duke u shprehur i kënaqur me përkushtimin e skuadrës dhe duke e kthyer vëmendjen te sfida e ardhshme me Serbinë. “Kemi bërë një ndeshje shumë të vështirë me Letoninë. Ata kanë luajtur një ndeshje shumë të ngjashme edhe ndaj Serbisë. Është një kundërshtar i fortë dhe fizikisht i fuqishëm. Nëse nuk arrin ta shënosh golin e dytë, mund të rrezikosh deri në fund të



takimit. E kemi parë Letoninë si ndaj Serbisë, ashtu edhe ndaj Anglisë dhe e dimë që janë të rrezikshëm në dy-tri raste që mund të krijojnë. Sa iu përket ndryshimeve në formacion, vendosëm ta aktivizonim Bajramin pasi mund të luajë jashtë zonës dhe të depërtojë. Duhet t’i japim merita kundërshtarit. Në pjesën e dytë, Broja kishte hapësira në sulm dhe bëri disa

kundërsulme. Ai është në ndryshim ekipi dhe e ka të vështirë ta tregojë veten me pak minuta në kombëtare. Nuk është një nr. 9 tipik, por mund të bëjë mirë duke depërtuar në zonë”, ka thënë Sylvinho. “Jam shumë krenar për lojtarët e mi. Jemi stërvitur për dhjetë ditë për këto dy ndeshje. E analizuam ndeshjen e kaluar të Letonisë me Serbinë, por tani s’mund të them se e kam në mendje. Pas tri ditësh vazhdojmë punën për të parë se çfarë do të bëjmë në përballjen ndaj Serbisë në tetor. Asllani është një djalë shumë i mirë dhe po bën mirë me skuadrën e tij të re. Nedim Bajrami ka bërë një rikthim shumë të mirë sot. Po punojnë fort, me kokën ulur, për të marrë rezultate”, ka deklaruar Sylvinho.

SHKURT

Akuza ndaj McLarenit për urdhrat në Monza: Pëlqejnë Norris kampion para Piastrit

Për të dytin vit radhazi McLarenit është kritikuar ashpër në Monza për rregullat brenda skuadrës. Këtë të diel urdhrat nga skuadra bënë që Lando Norris të parakalojë Oscar Piastrin në pistë pa dueluar, duke shkëmbyer pozicionet mes tyre pas një gabimi që mekanikët bënë me britanikun. Ky veprim është kritikuar nga të gjithë, përfshirë edhe Bernie Ecclestone, ish-pronarin e Formulës 1, i cili kritikoi ashpër vendimin e Andrea Stellës: “Nuk do t’i kisha ndryshuar pozicionet e pilotëve”. “Ata flasin vazhdimisht për drejtësi, por a është e drejtë të ndëshkohet Piastri për një gabim të bërë nga ekipi? Jo!” të krijohet përshtypja se McLarenit pëlqen Norrisin si kampion bote për pilotë dhe jo Piastri”, ka deklaruar Ecclestone. “Gabimet, si ndalesat e ngadalta në bokse ose dëmtimi i motorit, janë bërë më të rralla, por ato janë pjesë e sportit të Formulës 1. Vendimi i tyre është i dyshimtë, pilotët nuk duhej t’i ndryshonin pozicionet”, ka deklaruar Ecclestone.

Yamali: Nuk ëndërroj për ‘Topin e Artë’, por për të fituar shumë të tillë

“Nuk ëndërroj të fitoj një ‘Top të Artë’, por për të fituar shumë trofe të tillë”. Me këtë deklaratë sulmuesi i talentuar i Barcelonës, Lamine Yamal, zbuloi ambicien e madhe në një intervistë. “Mendoj se jam një lojtar që ka aftësinë ta bëjë këtë. Nëse nuk ia dal mbanë, do të jetë sepse nuk i kam bërë gjërat mirë ose sepse nuk doja. Kështu që ëndërroj të fitoj shumë dhe ditën që kjo të ndodhë, do të jem shumë i lumtur”, ka shtuar Yamal. Pavarësisht se është vetëm 18-vjeçar, Lamine Yamal tashmë konsiderohet kandidat kryesor për çmimin e këtij viti. Ai do të përballet me konkurrencë të fortë nga Ousmane Dembele, i cili fitoi gjithçka me PSG-në sezonin e kaluar. Sezonin e kaluar, në 35 paraqitje në La Liga, ai shënoi 9 gola dhe dha 13 asistime, duke kontribuar me 22 pikë në Ligë. Ai krijoi 64 raste dhe kompletoi 108 krosime, duke shfaqur cilësi elitare në zonën kundërshtare. Në të gjitha garat ai regjistroi 13 gola dhe 17 asistime në 38 ndeshje, duke dyfishuar numrin e tij nga sezoni i kaluar. Pavarësisht prej dëmtimit, ai ishte vendimtar në ndeshje kyçe, duke u bërë golashënuesi më i ri në historinë e “El Clasico”-s.

Tuchel pasi turpëroi Serbinë: Ishim të frikshëm, ky është standardi ynë

Anglia dha një paraqitje spektakolare në Beograd, duke mposhtur Serbinë me rezultatin e thellë 5-0 në kuadër të kualifikuesve të Botërorit. “Tre Luanët” dominojnë plotësisht, duke mos i lënë kundërshtarit asnjë hapësirë për reagim dhe

duke bindur edhe teknikun Thomas Tuchel. “Forma dhe loja e ekipit ishte e frikshme. Kishim intensitetin, disiplinën dhe mentalitetin e duhur. Objektivi ishte të mos lejonim asnjë goditje në portë, edhe pse Serbia është shumë e fortë në fushën e saj. Kjo

ishte një paraqitje ku u pa gjithçka, por merita është e lojtarëve. Ky duhet të jetë standardi ynë”, u shpreh trajneri gjerman. Një nga protagonistët kryesorë ishte kapiteni Harry Kane, i cili shënoi gol e në minutën 74 me fanellën e Anglisë, duke treguar

edhe një herë lidërsipin në skuadër. “Nuk është gjithnjë e lehtë kundër ekipeve që mbrohen me 11 lojtarë, por treguam durim dhe efikasitet. Ky kompeticion, në fakt, fillon tani. Do të ketë ndeshje të vështira deri në Botëror, por kjo fitore duhet të

shërbejë si pikë referimi për ne”, u shpreh Kane. Me këtë sukses bindës, Anglia konfirmon ambiciet e saj për një rrugëtim të madh drejt Botërorit, duke lënë pas një sfidë ku gjithçka funksionoi në mënyrë të përkryer.

Kompania Regjionale e Ujitjes SH.A
Regional Irrigator Company J.S.C.
Regionalna Kompanija za Navodnjavanje D.D.
"Radoniqi-Dukagjini"
DALJE
Nr.Proc. 579 Data 10.09.2025



Në bazë të nenit 8, pika 1 e 2 e Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të UA 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe vendimit nr. 578/09.09.2025 të KE, KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A, me datë 10.09.2025 shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e një pozite:

1. Titulli i punës: Zyrtar për pasuri dhe asete

Numri i referencës: 579
Vendi: Gjakovë

Ndërmarrja : Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar me mundësi vazhdimi, puna provuese (6) gjashtë muaj në pajtim me Ligjin e Punës.

- Niveli i pagës: Vlera e pagës bazë 616.70 euro.

Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A është Ndërmarrje Publike që në kuadër të veprimtarisë së saj përfshin grumbullimin dhe ofrimin e shërbimit me ujë për ujitjen e tokave bujqësore që shtrihen në perimetrin e sistemit të ujitjes në tri komunat të Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit. Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A dëshiron që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit si dhe plotësojnë kushtet e pavarësisë dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara :

- Fakulteti Ekonomik, Financa, Biznes apo të ngjashme;
- Minimum 3 vite përvojë pune
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (office)

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Mban shënime të sakta për të gjitha pasuritë, duke përfshirë vendndodhjen, gjendjen dhe vlerën e tyre;
- Zbaton një sistem të fuqishëm të gjurmimit të aseteve për të monitoruar lëvizjen dhe përdorimin e aseteve;
- Në bashkëpunim me njësitë përkatëse zhvillon oraret e mirëmbajtjes për të siguruar që asetet mirëmbahen dhe mbahen në gjendje të mirë;
- Koordinon mirëmbajtjen dhe riparimet për të minimizuar kohën e ndërprerjes dhe për të zgjatur jetëgjatësinë e aseteve;
- Monitoron amortizimin e aseteve dhe llogarit vlerën e tyre në rënie me kalimin e kohës;
- Siguron pajtueshmërinë me standardet dhe rregulloret e kontabilitetit në lidhje me zhvlerësimin e aseteve;
- Identifikon rreziqet e mundshme që lidhen me pronësinë e aseteve, të tilla si vjedhja, dëmtimi, shfrytëzimi, ose keqpërdorimi dhe tjetërsimi;
- Planifikon heqjen e aseteve që nuk janë më të dobishme ose me kosto efektive për ndërmarrjen;
- Identifikon mundësitë për zëvendësimin e aseteve për të përmirësuar efikasitetin dhe performancën;
- Përgatitë dhe dorëzon raporte mbi përdorimin, vlerën dhe performancën e aseteve palëve të interesuara;
- Eksploron teknologjitë në zhvillim, si sensorët identifikimi dhe teknologji tjetër, për të përmirësuar monitorimin e aseteve;
- Bashkëpunon me departamente të ndryshme, për të siguruar që nevojat për asete të përmbushen;
- Analizon të gjithë ciklin e jetës së aseteve, nga blerja deri te nxjerrja jashtë përdorimit, për të marrë vendime të informuara për zëvendësimet dhe përmirësimet;
- Për punën e vetë i përgjigjet Zyrtarit Kryesor Financiar;
- Regjistrimin e mjeteve themelore dhe inventarit në(financa /material);
- Regjistrimin (kontimin) e hyrjeve dhe daljeve nga magazine në (financa/ material);
- Kryen edhe detyra tjera shtesë të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga Zyrtari Kryesor Financiar/Kryeshefi Ekzekutiv;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet ZKF-së;

Procedura për aplikim

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Një C.V. e detajuar.
- Kopja e dokumentit identifikues.
- Letër motivimi.
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale te noterizuara.
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.
- Referenca nga punëdhënësit paraprak.
- Certifikata nga gjykata kompetente që nuk është subjekt hetimi për kryerjen e veprës penale, nuk është ne procedure penale dhe nuk është i dënuar nga gjykata kompetente për kryerjen e një vepre penale jo me te vjetër se 6 (gjashte) muaj.
- Aplikacionet mund të tërhiqen në KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë rruga e UÇK-së. Nr. 7, ose në faqen zyrtare të kompanisë: <https://kruradoniqi-dukagjini.com/>

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën zyrtare Objekti administrativ KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë rruga e UÇK-së. nr. 7. Konkursi mbetet i hapur tridhjetë(15) ditë kalendarike, afati i fundit për aplikim është data 25/09/2025 deri ne ora 16:00

Vërejtje: Kandidatet me dokumentacion te pakompletuar, te paplotësuar dhe pas afatit te konkurimit do te refuzohen. Do te kontaktohen vetëm kandidatet te cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe te përfshirë ne listën e ngushte.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Swiss aesthetic &Training” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812197227 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Swiss aesthetic &Training” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812197227 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Swiss aesthetic &Training” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812197227 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Elmedina Mehulli shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore e”Eena Gjika”.
- Ridvan Lushtaku shpall te pavlefshme dëftesat e klasës së 10,11,12,13 dhe diplomën e shmlt “Arkitekt Sinani”.
- “Timi ml Group” SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 812201804.
- Shege Behrami shpall te pavlefshme dëftesat, diplomën dhe certifikatën e testit te maturës te shmlm “Dr. Xheladin Deda”.
- Panda Music SH.P.K shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 810188997.
- Ilirian Halili shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.
- Menar Spahi shpall te pavlefshme Librezen e Notave shfmu “ Motrat Qiriaz i “ Prizren.
- Vatan Berisha shpall te pavlefshme 1 dëftesë QK “11 Marsi” Prizren.
- Yumin Emini shpall te pavlefshme certifikatën e notave shtetërore QK “ 11 Marsi” Prizren.
- Adnan Bajrami shpall te pavlefshme 3 dëftesat , certifikatën dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

F2.3/BNJ



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh.A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokolli 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokolli 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitën test me nr. protokolli 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 08/09/2025 me numër të protokollit 02/01/692 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK PA TEST (KJ/PT)
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës: Punëtor i Higjienës Publike
Nr. i kërkuar: Dy (2) pozita, NJO Drenas në KRM “Pastrimi” SH.A
Numri i Referencës: KP/PT/NJOD/29-2025
Koeficienti/Paga mujore: Niveli XIII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar
Perioda Provuese: 3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Kryen punët e përcaktuara në urdhëresën e punës nga udhëheqësi;
- 1.2 Bënë pastrimin e rrugëve sipas urdhëresës në terrenin e përcaktuar në urdhëresë sipas planit Operativ;
- 1.3 Përbushë detyrat në atë mënyrë për të mos penguar komunikacionin apo lëvizjen e qytetarëve;
- 1.4 Është përgjegjës për përdorimin e kujdesshëm të mjeteve të punës dhe raporton çdo problem lidhur me pamundësinë e kryerjes së punës;
- 1.5 Kryen edhe punë të tjera që kërkojnë nga udhëheqësi sipas nevojës;
- 1.6 Për punën e tij i raporton Kryepunëtorit të Higjienës Publike në Njësinë Operative

2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- ✓ Aftësia për të punuar vetë;
- ✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- ✓ Njohuri për sigurinë publike;
- ✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- ✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- ✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- ✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme)	✓
